


TRASHEGIMIA

Karl Eichinger: Në Shqipëri, ndjen historinë e këtij vendi

Pianisti austriak: Ju rëfej si erdha në Tiranë për koncert



Rudina Hoxha

Pianisti austriak, Karl Eichinger ishte në Tiranë ditën e premte ku interpretoi "Rapsodinë Blu" të kompozitorit dhe pianistit amerikan, George Gershëin për më shumë se një orë në sallën e Universitetit të Arteve me praninë e një audience të gjërë.

Ky koncert, i organizuar nga Ambasada Austriakë në Tiranë, në bashkëpunim me Orkestrën Simfonike të Radiotelevizionit Shqiptar, erdhi si rezultat i një bashkëpunimi që zë fill në qershor të 2013. "Më pëlqen të vij prapë të luaj në Shqipëri. Falenderoj Z. Tukiqi, drejtorin artistik të Orkestrës Simfonike Shqiptare dhe Ambasadën Austriakë në Tiranë për mbështetjen e tyre dhe mbi të gjitha publikun shqiptar që e dëgjojnë muzikën time me endje", thotë pianisti nga Sankt Pulten, kryeqyteti i Austrisë së Ulët, në një intervistë ekskluzive fill pas kon-

certit.

Si shkoi koncerti? Sipas jush si e prit atë audiencë shqiptare?

Unë them se shkoi shumë mirë. Publiku shqiptar pëlqeu muzikën që ishte një përzierje e muzikës klasike me atë khaz. Në përgjithësi, muzika e Gershëin është e veçantë.

Cfarë ju bëri më shumë përshtypje gjatë këtij koncerti?

Shpesh drejtoja shikimin nga publiku dhe vura re se njerëzit po dëgjonin me shumë vëmendje.

Shqipëria është i vetmi vend në rajon ku ju keni dhënë tashmë koncertin tuaj. Si ndodhi?

Kam disa miq shqiptarë në Austri. Ata janë artistë. Një ditë të bukur më pyetën se pse

një bashkëpunim për koncerte për piano dhe orkestrë. Mund të them që bashkëpunimi im me Shqipërinë filloi qershorin e kaluar deri në realizimin e këtij koncerti ditën e djeshme.

Përse zgjodhët "Rapsodinë Blu" të Gershëin?

Kjo ishte një zgjedhje e imja në fakt. Jam një fans i Gershëin sepse ajo ka vetinë që të kombinohet me elemente të muzikës khaz. Mua më pëlqen jo vetëm të fokusohem në muzikën klasike por edhe pak në atë khaz.

Na thoni diçka lidhur me karrierën tuaj artistike?

Isha 11 vjeç kur në shkollë pashë një piano diku në një cep të një dhome. Fillova t'i bie dhe kështu fillova rrugën e artit. Shkova në shkollën e muzikës. Në moshën 18-

monë një mënyrë për mua që të shprehja vetveten.

Fillimisht kam luajtur si solist. Më vonë fillova të bashkëpunoi me disa këngëtarë në Austri. Pas kësaj u bëra pjesë e ansambllit "Vienna Symphony Virtuosi" i cili ka një aktivitet të dendur që nga 1978. Unë jam e pjesë e tij që prej 20 vitesh. Ai përbëhet nga 4 muzikantë, që luajnë përkatësisht në trombë, piano, flaut dhe trumpetë. Ky tingëllon një kombinim i çuditshëm. Dhjetorin e kaluar, ne bëmë një tur dy-javor në Kinë. Kemi dhënë koncerte në Amerikë, Afrikën e Jugut, vendet e lindjes dhe Austri padyshim.

Dhe Shqipëria ishte vendi ende i pazbuluar nga ju?

Po, por të them të drejtën, sa vura këmbën në Shqipëri,

sikur ndjeva pak historinë e saj, do të thoja. Të gjithë e dimë se periudha pas Luftës së Dytë Botërore nuk ka qënë e lehtë për Shqipërinë. Por tani shikon një rendje të shqiptarëve për të transformuar jetët e tyre dhe për të përqafuar një të ardhme më të mirë.

Isha 11 vjeç kur në shkollë pashë një piano diku në një cep të një dhome. Fillova t'i bie dhe kështu fillova rrugën e artit. **Shkova në shkollën e muzikës. Në moshën 18-vjeçare vendosa të studioj për muzikë në Vjenë, kështu derisa fillova të luaj nëpër koncerte**

nuk shkoja të luaja një koncert të bukur në Shqipëri. Kështu i shkruajta Ambasadës Austriake në Tiranë. Dhe përgjigja erdhi kur edhe Z. David Tukiqi kishte filluar

vjeçare, vendosa të studioj për muzikë në Vjenë, kështu derisa fillova të luaj nëpër koncerte. Unë nuk e kam trashëguar muzikën nga familja. Muzika ka qënë gjith-

FESTIVALI NDERKOMBETARI I BERLINIT HAPDYERT ME 6 SHKURT

Festivali Ndërkombëtar i Berlinit, është i pari nga festivalet kryesore evropiane që mbahet këtë vit dhe mes kandidatëve janë filma të regjisorëve Wes Anderson dhe George Clooney, Steven Soderbergh dhe Gus Van Sant, si edhe një numer filmash konkurrues nga Kina. Orga-

nizatorët e të ashtuquajturës Berlinale bënë publike listën e 23 filmave pjesëmarrës, 20 prej të cilëve konkurrojnë për Ariun e Artë. Në festival ka edhe konkurrentë nga Irani dhe Kazakistani si edhe një numër filmash nga Evropa Lindore, mes së cilëve "An Episode in the Life of an Iron Picker," i regjisorit boshnjak fitues i çmimit Oscar Danis Tanovic për një familje të varfër cigane,




"Child's Pose" i Calin Peter Netzerit që e vë theksin tek korrupsioni në Rumani dhe "In the name of" i Malgoska Szumowska, për një prift homoseksual në Poloni. Regjisori i festivalit Dieter Kosslick thotë se programi i festivalit që do të mbahet nga 6-16 shkurt, në një farë mënyre ndjek një kronologji që fillon me të kaluarën. Ngjarjet e filmit të ri të Wes Andersonit "The Grand Budapest Hotel" zhvillohen në një hotel evropian në vitet 1920. Në festival shfaqet edhe drama "The Monuments Men" me ngjarje nga Lufta e Dytë Botërore e regjisorit George Clooney. Yjet pritet të mbushit karpetin e kuq, përfshirë Clooney-n, Uma Thurman, Willem Dafoe, Patricia Arquette, Catherine Deneuve e të tjerë.

ROMANI RI NGA KIÇO BLUSHI, "GJUHA E GJAKUT"

Mirë në burg apo në shtëpi? Në romanin e ri të Kiço Blushit, botimet "Nami", dilema nuk i referohet botës së krimit, por njerëzve të zakonshëm që edhe kur duan të dëshmojnë mirësi dhe dashuri marrin si shpërblim të kundërtën. Pas disa vjetësh në emigracion, burri kthehet në shtëpi, diku në një nga fshatrat e Lezhës. Mirëpo një aromë parfumi e gruas, që mezi e

priste njeriun e saj më të dashur, si edhe disa ndryshime të tjera në "Shqipërinë e re", do të shkaktojë në "ububu"-në e një xhelozie të tërbuar, pasuar me viktimë të pafajshme. Burri projekton "të dashurin" e gruas dhe kërkon që ajo vetë ta ekzekutojë për të dëshmuar me provë të kundërtën... Nga ana tjetër, t'atit të



vajzës, një rapsodi vejan, sikur të mos i mjaftonte edhe turpi pse dikur kishte kënduar një këngë për Diktatorin e përmbytur (dhe për këtë militantët e pushtetit të ri e kishin sakatuar), tashmë i kthehet edhe vajza lëneshë... Se çfarë do të ndodhë, pse do të ndodhë; këtë e thotë shkrimtari Kiço Blushi përmes një rrëfimi dhe analize të hollë për shpirtin dhe mendjen e trazuar të shqiptarit të sotëm, ku paradoksi dhe egërsia është bërë stil jetese.